



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSSHME
AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

SQARIM

Organi Qendror Blerës, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka publikuar procedurën e prokurimit me mjete elektronike, “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”, me objekt “Blerje uniforma për Policinë e Shtetit dhe aksesore që e plotësojnë” për plotësimin e nevojave për periudhën 2018, 2019 dhe 2020, me fond limit total për 3(tre) vjet në vlerën prej 908,973,900 (nëntëqind e tetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e nëntëqind) lekë pa TVSH.

Në zbatim pikës 1 të nenit 42, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar autoriteti kontraktor nisur nga një kërkesë për sqarim e ardhur në sistemin elektronik të APP-së, ka hartuar këtë sqarim mbi specifikimet teknike për dokumentet e tenderit si më poshtë:

1. Përmbajtja e skedave teknike duhet të përfshijë informacionin e trajtuar në aneksin në fund të çdo dokumenti të specifikimeve teknike, sipas metodave të testimit. Skeda teknike duhet të përfshijë informacionin për tekstin kryesor të prodhimit të artikullit, për të cilin janë dhënë kërkesat fiziko - mekanike dhe kimike dhe që është kërkuar të paraqitet si kampion. Skedat teknike, në varësi të prodhuesit të tekstileve mund të përmbajnë dhe të dhëna të tjera fiziko - mekanike dhe kimike, por është e rëndësishme që informacioni i kërkuar nga AK të jetë i përfshirë në skedë.
2. Përsa i përket materialeve ndihmëse si astar, frazelina, përforcues, velcro, fileto, fije, etj nuk kërkohej skedë teknike për këto materiale.
3. Për aksesoret si kopsa metalike, stema metalike ose plastike të emblemës së kapeles, shiriti i zi i kapeles, ornamentet e jakës, togëza metalike etj është kërkuar që të paraqitet deklarata nga prodhuesi për vërtetësinë dhe cilësinë e materialit të përdorur.
4. Përsa i përket veshjeve që kanë elementë reflektivë në aneksin që përfshin listën me testimet që duhet të shoqërojnë artikullin janë përfshirë metodat e testimit të materialeve reflektive. Për këto artikuj duhet të sigurohet edhe skeda teknike e materialit reflektiv sipas metodës së testimit të vendosur në specifikimeve teknike.
5. Përsa i përket jelekut të shpëtimit për fibrat pluskuese në aneksin që përfshin listën me testimet që duhet të shoqërojnë artikullin janë përfshirë metodat e testimit të fibrave pluskuese. Për këtë artikull duhet të sigurohet skeda teknike e fibrave pluskuese sipas metodës së testimit të vendosur në specifikimeve teknike.

Inkurajojmë operatorët ekonomikë pjesëmarrës që të lexojnë me kujdes të gjitha specifikimet teknike dhe aneksin me listën e testeve që duhet të shoqërojnë artikullin.